

PËRMBLEDHJE POEZISH

FADIL SHYTI

AFORIZMA

(Këto aforizma vijnë nga dat. 7. 06. 2010)



Fadil Shyti

29. Jeta, është dhuruese dhe sfiduese – tejet përvëluese: jep dhe merr, mbarësi dhe sherr!
30. Jeta, herë koprrace, herë dorëlibër, -herë, fort e ëmbël, herë-tejet e vështirë!
31. Marrëveshja ndër-vëllazërore, çelës i sigurt për FITORE!
32. Aty, ku marrëveshjet ndër-vëllazërore dhe ndër-njerëzore mungojnë, turpet dhe krimet, mbisundojnë!
33. Sa më pak vuajtje, sa më shumë punë, në këtë kohë furtunë!
34. Si gjethet, që, fërfëllijnë gjelbroshe, bien të verdha o bojëkafe; -kështu, -po na ikën koha ne shqiptarëve, - me pak punë e shumë llafë!
35. -Aty, ku ka shumë premtime, mos pritni shumë realizime!
36. Aty, ka betime, -dijeni se kishte zhgënjime.
37. Aty, ku ka shumë plane dhe zhurma; mesiguri, do të zhgënjehet turma!
38. Aty, ku anarki, ka shumë mizori!
39. Tani, kur po sundon tradhtia, -po ricopëtohet, po digjet e po shkretohet Shqipëria!
40. Kur ka trazime dhe mospajtje, -ka ndarje dhe dëshpërime!
41. Ku bëhet hajni, aty, s'ka përparim as njerëzi.
42. E zezë është fytyra e Pisit, kur tradhtinë ia bën Fisit!
43. Nuk të tradhton Fisi, -por të tradhton Pisi!
44. Jo, nuk tradhtojnë trimi as besniku, -por tradhtojnë frikacaku dhe i ligu!
45. Turpi, është vëllai i Lakmisë, të dy janë e zeza e njerëzisë!
46. E keqja e hasmit nuk të habitë, e keqja e fisit të tronditë!
47. Deliret e zeza, janë si vetëtimat, -godasin papritur dhe shumë çoroditur!
48. Turpi dhe Lakmia, pas vetes e kanë sherrin dhe tmerrin!
49. Marrëzia dhe Çmenduria, janë motra, mjerë kush i dëgjon dhe i shiqon!
50. Njerëzimi, shkëlqen dhe ngadhënjën nga heroizmat.
51. Njerëzimi, nxinë dhe ngulfatet –(mbërthehet), nga idiotizmat!
52. Pasuria dhe varfëria janë të larmishme nga tmerret dhe lukset, nëpër botë.
53. Pasuria dhe varfëria; bien dhe ngjiten shkallëve të jetës.
54. Sa i madh është "humanizmi" kapitalist: në disa vende, mungojnë qirinjtë në oda, -kurse, në vende të tjera, ndezin mijëra llampa elektrike -edhe nën varre!!!
55. Sa i madh është "humanizmi" kapitalist: njerëzit nëpër botë po vdesin nga uria dhe luftërat, ndërsa, kafshët shtëpiake po majmen në paqe,-lart në pallate.
56. Themelet e turpeve dhe të krimeve, -rrënjët i kanë në kulturën e civilizimit të ulët të botës njerëzore.
57. Themelet e turpeve dhe të krimeve, -shkallët i kanë -dhe në ngjitjen marramendëse të teknikës vrastare,-nga vrasësit e paqes.
58. Shkëlqimet e jashtme, i fshehin pislleqet e brendshme të botës "njerëzore"!

Suedi, 11 Shtator 201

Fadil SHYTI

SYPETRITËVE

(Kushtuar shokut tim dëshmor, Enver Halitit dhe bashkëluftëtarit të tij kushëri, Muratit, nga Arbëria e Skënderajit)

Rrëzë maleve të Drenicës,
Që shekujve, ranë stuhi e tragjedi!
U lindën dhe u rrit Enver Haliti
Për Ty, moj Nënë Shqipëri!
Djalë sypetrit e guximtar,
E njohu Universiteti,
E njohu arsimi, dituria,
Kur mbrohej IDENTITETI!
Atë, ilegal mali,
E ngriti dhe edukoi
Të çeliktë, -Partia,
Për të mbi të gjitha,
Ishte Shqipëria!
Enver Haliti, -ilegal trimërie,
E njohën burgjet titiste,
Përballë xhelatëve të zi,
Që i polli fashizmi!
Qëndroi i patundur,
Në qelitë armike,
Për gjuhë, art e kulturë,
Të veprave heroike!
Atë ilegal mali,
E përqafoi Malësia,
Qëndroi, tok me popull,
Kur pamëshirë- godiste
E keqja, Serbia!
Kur në malet tona,
Krisi luftë e rreptë,-çlirimtare,
U rilind , Enver Haliti,

Krye detyrës atdhetare!
Po, Murati i pathyeshëm,
Komandant graniti,
Me armë në dorë -qëndroi,
Pranë Bacokut, -sypetriti!
Atë ditë rënkuan malet,
Andej nga Qyqavica,
Peshën e hidhërimit
E ndjeu atje, -nga PAVDEKËSIA,
Vetë Azem Galica!
E ngritën Flamurin -dy shkaborë,
Të larë me gjak:
Për hakmarrje, – i ri e plak!
U përflakën dhe u përgjakën:
Fehmi Lladrovci e Xheva,
-e Fatimja, si flakadanët
Ranë në llogore,
Si dikur partizanët!
Atë ditë u ri-ngrit, në pavdekësi,
Hamit Hyseni i urtë,
Snajperist, Vetëtima,
Sa shumë shtroi futa,
Mbi shkije e shkina!
Dhe mësuesi, Mustafë Shyti,
Ato çaste ra në llogore,
Duke sulmuar çetnikët,
Për të shtrenjtat FITORE!
Armët po i shtrëngonin,
Azema e Shota,
Për lirinë e Kosovës,
Jehonin malet tona,
Alarmonte, -bota!
Toka dridhej,
Nga tanket serbe,
Qielli lëshonte zjarr,

-Dhe, vetëtima lëshonte
Atë ditë Kosova Shqiptare,
Serbinë po e dërrmonte!

Suedi, 14.12. 2010

...DHE THONË!

...Mos i qani, me lot,
Heronjtë dhe heroinat,
Që jetën ia falën Shqipërisë!
E, qe besa kjo ide,
Hiç s'më duket me mend:
Për ata dhe ato; -duhet të qajnë...
Pa mbarim deri në amshim!
Jo vetëm njerëzit, qielli e dielli,
Por edhe Toka me Detet...
Duhet me u çmendë!

Suedi, 14.12.2010

TË TILLË JANË!

Puthadorët, - horrat reaksionarë,
Ishin, janë, DHE DO TË JENË,
-PËRÇARËS, të pamëshirë!
Në "miqësi"-me revolucionarë,
Sepse, shekujve -kurdoherë,
Bota e ka parë, fort mirë,
Se GJITHMONË:
Hijet i pengojnë
DIELLORËT,
Të ngrohin tokën,
E, njerëzimin mbarë!

Suedi, 18 nëntor 2010

POEMË

INTERNACIONALISTIT IDEOLOGUT TË MADH TË VETËVENDOSJES

(Kushtuar mikut të madh të kombit shqiptar, William Walker)

...Ah! Miku i madh Wokeri,
Plaku i urtë nga Amerika,
Nuk mashtrohet nga kolltuqet,
As nuk di, ç'është frika!
Si engjell - mjekërbradhi,
Vjen krenar në Prishtinë,
I thërret me guxim shqiptarët,
Ribashkohuni me Shqipërinë!
Përkrahë Vetëvendosjen,
Parimin e lirisë!...
Që ia hap shtigjet,
Barazisë së njerëzisë!
E përkrahë Albinin,
Vizionarin e ri,
Që, nuk matet -me stuhi deti,
Qëndresa heroike e tij!...
Ah! Miku i madh Wokeri,
Plaku i urtë nga Amerika,
Nuk mashtrohet nga kolltuqet,
As nuk di- ç'është frika!
Po tregohet shqiptar,
Madhështori!
Që ua kalon ca shqiptarëve,
Po tregohet më trim e bujar,
Që ua kalon shumë pushtetarëve!
Se disa pushtetarë, qyqarë!
Po e mohojnë veten- si kërmij pusat,
Po e duan jetën!...
Ah! Miku i madh Wokeri,
Plaku i urtë nga Amerika,
Që kërkon ribashkim me Shqipërinë,

Kurse, këta pusa, po kërkajnë
Dialog me Serbinë!
Ay, po marshon i qetë,
Si lumi me valë...
Po e rrezikon jetën,
Për të madhin ideal!
Ay, po e rrezikon përditë,
Jetën për ne!
Kurse, Saloja me kompani,
Dhe, në Kosovë me shkretanët,
Si "homologët, kokoshët e tij":
Po e duan, të ricopëtuar,
E, të ndarë –këtë të uruar,
Sh q i p ë r i!
...Ah! Miku i madh Wokeri,
Plaku i urtë nga Amerika,
Nuk mashtrohet nga kolltuqet,
As nuk di ç'është frika!...

Suedi, 10 12.2010

CETËS SË AZEM GALICËS

Atyre burrave madhështorë,
Sa hije u kishin armët në dorë,
Ata burra të Shqipërisë,
Ishin tmerri i tradhtisë!
Ata burra të Arbërisë,
Ishin tmerri i Serbisë!
Ata - shokë të Azemit,
Lum që i kishin - malet e vendit!
Ata, ishin krenaria,
Ata, ishin nderi!

O, sa shumë i vlerësuan,
O, sa shumë i nderuan,
Partia dhe Enveri!
Në odën e pritjes të Enverit,
Qëndronte krenar si lapidar,

Fotografia e ndritur e Azemit,
- Kur e pyetën komandantin:
- Shumë e nderon Azem Luftëtarin?!
...Ah! Për nderimin e Azemit,
U mendua - e foli vrer:
- Me gjëmë e dhimbje - si përherë:
“Azem Galica, - e meriton nderimin,
Ai, luftoi me krajli,
Kurdoherë - e dha kushtrimin,
Vrau, shumë serbë-faqezi!
Azem Galica, - tërë jetën e tij,
Luftoi maleve të Kosovës,
Për ta bërë Kosovën - Shqipëri”!
Po, Shote Galica, - ajo Heroinë,
Me luftën titanike, - 12 vjeçare,
- A nuk e meriton titullin e nderit:
- E, ta thërrasim me dashuri
- Ndër brezni:
NËNA JONË SHQIPTARE!

Suedi, 27 Nëntor 2010

KONTRASTE!

Zor, shumë zor,
Koha me stuhi,
Ndër shekuj në histori,
Të shanë, po të shajnë,
Të lanë e po të lajnë,
Në lot e gjak!
O, kombi im!
Por, si për dreq,
Në këtë botë,

Ka edhe më keq:
Ka edhe - zi e më zi:
- Sikur të pajtoheshe,
Sikur të përqafoheshe,

Përlësisht, verbërisht,
O, populli im,
Me robëri e tradhti!
Nëse do të shtroheshe...
Nën thundrat e armiqve,
Dhe, tradhtarëve-xhelatë -zi!

Suedi, 10 07.2010

LUMË E MJERË!

Lumë trimat për plagët e trupit,
Mjerë qyqarët, për - jargët e turpit!
Plagët, - një ditë – edhe mund të shërohen:
Ndërsa, - ato hata:
Njolla krimesh e - tradhti - turpe,
Kurrë, as shekujve nuk harrohen!
Mbase, edhe - nuk u shëruan plagët!
O, lumë ata, që nuk u zhytën në jargë!

Suedi, 10 .07.2010

KRENARI!

Lumë, si ata dhe ato,
Që ndër brezni:
SHEKUJVE:
Qëndruan, vertikalisht!
Folën e shkruan-jetuan:
PELLAZGJISHT, ILIRISHT,
ARBËRISHT dhe SHQIPTARISHT!
Punuan, mësuan dhe luftuan...
E, kurrë s' u dorëzuan,
E, kurrë s' u tjetërsuan!
Lumë ato zemra margaritare,
Që e ruajtën dhe forcuan,
GJENIN - e shenjtë, - me vulat shqiptare!
Me gjuhën, qeleshen e flamurin shqiptar,
Kurrë nuk bën “reformime”- ndryshime,
Kurrë nuk bën tregti, - si faqezi!

Por u lindën dhe "vdiqën" kombëtarë!
U lindën dhe "vdiqën" proletarë!
Kurrë as tradhtuan, as u pasuruan,
Me krime dhe turpe!...
As përfituan pushtet-pa shtet!
As u zezuan, me ngjyrosjen,
E, përdhosjen, - ligësi-tradhti!
Por, përballë furtunave historike,
T'i ruajtën si sytë e ballit - dhe si lotin e mallit:
NDERIN DHE ARDHMËRINË TËNDE,
Moj e dashura, përjetësisht,
Nënë SHQIPËRI ETNIKE!

Suedi, 10.07.2010

BESËPRERËVE

Revoltë ndaj atyre që veprojnë
kundër Ribashkimit të Shqipërisë!

Me një fytyrë dukeni,
Një mijë fytyra i keni!
Si minjë labirintëve breni,
Të dështuar jeni!

Jeni të prapë o bukëshkalë!
Me qindra shekuj prapa,
Ecni mbi tokë, si të pa kokë,
Kurrë s'ecni me hapa!

Mashtrues të çoroditur,

Ah! Populli s'po ju njeh,

Juve, o të babëzitur!

Veçse sherrin ua sheh!

Mbaheni me krekosje,

Ngriteni me llafe të kota!

Prej veprave tuaja të poshtra,

Neveritet dhe çuditet bota!

Ju, e shkelni besën, nderin,

E përdhosni dhe flamurin,

Ju lirisë ia pini gjakun,

Atdheut ia prishni nurin!

Gjeni juaj monstër e keqe!

Atdheut po i sjellë veç kobe,

Nga prapakthimet kryeneqe,

Mbytë ideja juaj robe!

Deri kur o ju kokëderra,

Do t'ju shkojë kungulli mbi ujë?!

Të pakurriz, xhelatë përhera,

Jeni vënë n'shërbim të huaj!

Pa menduar e peshuar:

Vala popullin ku e qet,
Ju që shpikni dhe komb tjetër,
Një komb jemi or të shkretë!

Shqipëria e RIBASHKUAR,
Ore horra ju pengon,
Se pastaj nuk mund ta zhvatni,
Pasurinë e atdheut tonë!

Ju, mjeranë besëprerë!
Nuk mendoni për Shqipërinë,
U ka marrë koka erë,
Të mbuluar me marrëzinë!

Shumë të etur për nderimet,
Nga të huajt e zi dinakë,
Si s'po shihni o të uruar,
Që po futeni në batak!

Të verbuar nga premtimet,
Për integrimet në Evropë!
Fatkeqësi me ndarje t' kombit,
Po përhapni, nëpër botë!

Po harroni o të krisur!
Evropa për ne nuk bashkohet!
Prap këndon këngën e vjetër:
Shqipëria të ricopëtohet!

Pansllavizmi nga Karpatet,
Si kulçedra me gjarpri,
Të uritur me shumë orekse,
Po e kafshojnë, nënën Shqipëri!

Mos harroni o kopukë,
Anemikë, kozmopolitë,
Koha do t'ju dënojë idhshëm,
Po pajtoheni me armik!

Mos provoni të mbani copa!
Kot e ka ai që provon,
Një ditë Kombi do ribashkohet,
Gjithësesi, heret a vonë!

Sot Shqiponja e trazuar,
Kur ju sheh, sa po tronditet!
Kur zgërdhieni me armiq,
Me flatra rrufeshëm valvitet!

Trupi saj mjaft u copëtua!
Gjatë qëndroi! E ndarë një shekull,
Gjaku ynë kurrë nuk shterret,
Për ta bërë Shqipërinë t' paprekur!

Ju, Shqipërisë krajata i sillni,
Veç ato në koka i keni,
Me turpe-krimet që po bëni,
Asgjë tjetër veç Hiqër jeni!

Kështu Shqiponja alarmoi,
Ajo kurrë s'e humbë QËNDRESËN!
Kundër saj kush ngriti kokën,
Si tradhtar e vrau veten!
Suedi, 26 prill 2006

RIBASHKIMI KOMBËTAR

Na duhet si uji,
Na duhet si buka!
Na duhet si ajri,
Na duhet si dielli!
Na duhet si toka,
Na duhet si qielli!

Me Shqipëri të ndarë:
Jeta s' ka kuptim!
Nuk gëzohet paqja,
Pa RIBASHKIM!
Prap na kërcnon lufta,
Atdheu, s'po gjenë shpëtim!
Suedi, 21 Mars 2006

JETA

Jeta mrekulli,

Jeta stuhi!

Ledhaton or mik,

Kafshon moj mike!

Jeta, në rrugëtimet e veta...

Herë na merr për dore,

Herë na shkelë me këmbë,

Herë na përqafton ngrohtë,

Herë na kafshon me dhëmbë!

Herë si engjëllëshë,

Herë si xhelate,

Herë si dreqe!

Çdoherë pranë nesh:

Vjen enigmë,

Vjen kryeneqe!

Eh, e tillë është jeta:

Me ledhatime e kafshime

I mbushë kupat e veta...

Suedi, 12 Dhjetor 2005

LARG SHQIPËRISË

Ftohtësia nordike,

M'i mpiu muskujt dhe kockat!

Largësia nga Shqipëria,

Si darë xhelati,

Po ma shtërngon zemrën!

Sa malet tona ma rëndon shpirtin!...

Por, Vigan Mërgimtari, përballon stuhinë;

Natën vonë këndon:

Kujtimet për Shqipërinë më rinojnë!

Do vijnë ditëveret e vizitave:

Për qetësinë e shpirtit!

Për lehtësinë e zemrës!

Zogjtë e shqiponjave!

Hapësirat e Atdheut kërkohen!...

trazim i natës së thellë...

Suedi, 13.01.2006, 03.05

QËNDROJ!

Në kraharorët e mi,

Pesha e robërisë rëndon!

Po kafshojnë dhembjet, plagët!

Janë sforcuar muskujt,

Po ndizen flakë!

Janë tendosur nervat!

Dhe, unë hapëroj,

Netë - ditë,

Ditë - netë!

Qëndroj!

Heu, mirë se vini plagët e mia,

Nuk jam i vetmuar,

Se, plagë po ka sot,

Edhe SHQIPËRIA!

Vetëm kur NËNËLOKJA shërohet,

Shpirti im qetësohet!

Përndryshe, JO kurrë!

Se, atëherë s' jam shqiptar,

Jo, nuk jam burrë!

E di se atëherë,

Nuk kam vlerë!

Jo, nuk jam vëlla i Migjenit

O, i Gjergj Elez Alisë,

Kur s'i pranoj në trupin tim,

Dhe plagët e Shqipërisë,

Krenarisht, sfidoj, qëndroj!

si mëngjes revolucionari.

Suedi, 11 Mars 2006, ora 04.38,

PLAGËT TONA

(Invalidëve të luftërave tona çlirimtare)

Ne, jemi kryengritës breza-breza!

Në trupat tona me plagë-drite,

Kemi vënë proteza;

Disa prej tyre thellë në kocka na futen,

Eh!...

Kemi të tjera më të thella,

Që fare nuk duken!

Suedi,12.08.2005

SHQIPËRIA KËRKON RIBASHKIM

(Kushtuar, Jasharëve legjendarë)

Breshëritë e plumbave barbarë,
Mbi kullat tuaja flakadane lirie,
Janë gjurmë të pashlyera

Të një kohe të zezë barbarie!

Janë gjurmë të thella Qëndrese,
Si luftuan luanët e lirisë
Me besa-besë, shpresë,
Për Ribashkimin e Shqipërisë!

Axha Shaban, me Ademin e Hamzën,
Me nipa e mbesa, me besa-besë:
Dijtën, guxuan, paralajmëruan
Mauzerrëve,t'ua ngrehin këmbëzën,

Luftën Çlirimtare Shqiptare,
Nga nata e zezë shekullore-mizore

E filluan, Kosovën me Vise e zgjuan
Drejt fitoreve të reja!...

Ashtu, kurdoherë na thërrasin,
Me kushtrimin :
Përjetë Qëndroni!
Shqipëria kërkon Ribashkim!

Prekaz, vjeti 2000

NUK GJEJË PREHJE...

Nuk gjejë prehje në jetë,
pa e parë një dritë,
që aq shumë e kemi pritë,
Nuk gjejë prehje në jetë,
pa e parë një Fitore,
për të cilën derdhëm
djersë e gjak, i ri e plak
në burgje dhe llogore!
Nuk gjejë prehje në jetë,

pa e parë një bukuri,
RIBASHKIMIN e trojeve etnike,
Me Nënë Shqipëri!
Nuk gjejë prehje në jetë,

pa qeshë fytyra e malësorit,
pa u flakur shfrytëzimi i punëtorit,
Nuk gjejë prehje në jetë,
pa fituar drejtësia...
pa u thyer e vrarë tradhëtia!
Pa lulëzuar Shqipëria Etnike,
pa u dëshmuar me vepra heroike!
Nuk gjejë prehje në jetë,
pa njohje trimash të vërtetë,
që Atmëmédheut ia falën,
të shtrenjtën jetë!...
Poezi nga përbledhja poetike, "Në kërkim drite" Tiranë, 1

BILBIL I ÇMENDUR

Fat i hidhur nëpër botë,
Si bilbil po më ngarend,
Larg teje o Atdhe,

Herë-herë, po më çmendë!...

Malmö, 15 dhjetor 2003.

VËSHTRORJ TË BUKURËN

Përballë krajetave tehshpatave

Nga mizoritë e jetës:

Të rrugëlirisë drejt së vërtetës,

Mbi armiqësi e tradhëti:

Triumfoi!

Kur të bukurën o madhështoren,

Bile, për një çast e vështroj!

Oh!...

I ndiej për një çast:

Qetësi, hare, lumturi!

Tejet të thellë shpirtërore.

Ah, sikur ta mbizotëronin botën

E bukura, madhështorja, fitorja!

Këtë botë mjerane,

Ku përkohësisht jeton,

Ku përkohësisht vuan,
Ku pakufishëm qëndron,
Qënja njerëzore.

LAMTUMIRË!

Të përshëndes me grusht e besë,
O Atdhe, këtej lart nga aeroplani,
Në këto çaste mizore shpirtërore
Kur më tundon tufani!...
Afër teje,
Larg tokës!
Lart teje,
Larg, Shqipërikosovës.
Në veri bënë kohë e ftohtë,
E, në veçanti për ne,

Jo, nuk gjejmë qetësi,
Larg tonit Atdhe!
Lamtumirë, toka jonë,
Lamtumirë yni diell!

Kemi mbetur në mërgime,
As në tokë as në në qiell!
Po ikim larg teje o Atdhe,
Me shpresat e këthimit,
Po rëndojnë keq mbi ne,
Ditë-netët e mërgimit!
Lamtumirë toka jonë,
Lamtumirë yni diell,
Kemi mbetur në mërgime
As në tokë as në qiell!...
Prishtinë, 29 gusht 2003.

REBELIM

Rebelim, me kushtrim,
Rebelim, për shpëtim,
Rebelim, për punë,

Jetën ta bëjmë qëndrim,
Nëse duam që kjo të ketë kuptim!
Rebelim, edhe në dashuri!...
Nëse duam të ketë ardhmëri,
Për filizat e reja, për brezni!...
Rebelim për Ribashkim!...
Malmö, 20 prill 2004

NË KËRKIM

DRITE

Poezi

Tiranë, 1996

KUSHTRIM RIBASHKIMI

Gjyshit tim, Hajzer Tafa Shytit, i cili me armë në dorë,
luftoi për Liri e Ribashkim Kombëtar!

DËSHMORËVE

Përvjetorëve,
Përkulemi tek Ju, me respekt,
Nën tingujt e himnit të Flamurit.

Dje Besë e Qëndresë
Mm zemrat prej guri!

Sot-Kushtrim
Për Ribashkim.

FAT I KOMBIT

Fat i Kombit në teh shpate
Mbijeton histori nate!

NË TOKËN SHQIPTARE

Të errëta burgjet,
të rënda sfidat,
të egra tradhtitë,
të vjetra intrigat,
të shumta pritrat.

E madhe, shumë e madhe
Besa,
Qëndresa,
Dashuria.

NUK MBYTEN IDEALET

Martirëve të kombit

Qëndruat të përgjakur,
qëndruat të uritur,
qëndruat të etshuar.

Plagët ende të hapura.

Erërat ulurijnë hata,
mund t'ju përballojnë
veç zemrat e mëdha,
Rrugë e gjatë
deri te Fitorja.

Mund t'ju përballojnë
veç mendimet-dritë.

DETI DHE KOSOVA

Deti përballon shekujve stuhitë,
Kosova-robëritë!

Në qetësinë e Detit
e shoh durimin e Kosovës.

Në trazimin e Detit
e ndiej kushtrimin e Kosovës.

Mbi Det gjithçka noton.
Deti vetëm heshton.

Në Kosovë e liga kaliron-kafshon.
Kosova çuditërisht duron!

Detin e mbajnë malet.
Kosovën - idealet.

NË KËRKIM DRITE

Flokët më thinjen
për njëzet e katër orë,
sikur t'i kisha dymijë vjet.

jetë

në kërkim Drite!

Jetë-stuhi!

MILITANTËVE

Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut,

të rënë heroikisht në altarin e lirisë!

Kur po e gjakosnin kanibalët
atdheun tonë të copëtuar

Ju o militantë,
me krisma trimërie
e gjak të zemrës
dëshmuat
si duhet
Liria!

Prandaj,
Afrim e Fahri
do me thënë:

Kushtrim

e Ribashkim

i trojeve shqiptare!

TY

(Jakov Xoxës, shkrimtarit tonë të madh,
që penën e vet ia përkushtoi njerëzve të thjeshtë,
të punës, të dritës).

"Lulja e kripës" prore lulëzon,
"Lumi i vdekur" nuk morton!

Adili e Vita pa ndarë vështrohen,
dita-ditës po (Ri) bashkohen!
Apolloni, (1979)

DHUNA

Tanksa vrastare,
aeroplanët luftarakë,
kombin liridashës
seç e lajnë në gjak!

STUHI, LOT E GJAK
Motrës, Azize, larg së cilës lumturia
jetësore sikur më është fikur!...

KUR MËRGOVA

Pasaportën false
e kisha.

Me vete kisha dokumentat e burgut.

Ftesën që të lajmërohesha
në strofullën e ujqërve,
me firmën
milici!

Me pasaportën false
po mërgoja!

MËRGIMTARI

Mallin që më djegë,
mallin që më kallë,
s'ë shuan kurrën e kurrës,

as deti me valë!

Këtë zjarr,
e shuan veç jeta,
kur Shqipëria Nënëloke,
më pret në supet e veta!...

AUTOBIOGRAFIKE

Albulenën - lulëkuqe, simbol.
Emblemën që më bënë nderë,
shekujt më dhuruan krenari,
nga xhaxhi Skënder.

Nga kryetrimi Kastriot,
I njohur për trimëri,
Emri i tij, thotë: Liri,
Anekënd nëpër botë.

Yllin - idol Lirie,
Gjithmonë simbol barazie,
Fshehur zemrës , fllad stuhie
ballit - vulë krenarie!

Artën - paralajmërim për Ribashkim
Kujtesë për gjënim e brezni,
Ndaj coptimit të dhunshëm
Të së shtrenjtës Shqipëri.

Dhe unë, Qëndroj, Qëndroj!
Përballë valëve epike,
Valëve të vandalëve të egër,
Në këto çaste historike.

Edhe gruaja ime kryengritëse,
Ndjenë dhembje nga lindjet prore,

Për të firmosur edhe me gjak,
Idealet tona jetësore...

Fadil Shyti

DRITE LIRIE!

Kur trojet shqiptare, po rënkonin

nga thundra e robërisë,

Më 8 Nëntor 1941, flakëroi –sulmoi një dritë-rrufe,

Mbi armiqtë, në qiellin e Shqipërisë!

Rinia heroike shqiptare,

Po betohej me grushta lart!

Komandant, Enveri i tha jo reaksionit,

Kur përpëlitej e zvarritej përçartë!

Qemail Stafë shkodrani,

Po e jepte kushtrimin:

Ta luftojmë fashizmin!

Ta bëjmë ribashkimin!

Lokemadhja Bije Vokshi,
Me revolver e bomba në duar,
Si Shote Galica e Norë e Kelmendit,
Ju bënte roje flakadanëve, për lirinë e vendit!

Emin Duraku, ylli i Kosovës Kreshnike,
Do lidhej si gjaku me zemrën,
Në qëndresë kundër nazi-fashizmit,
Përkrah rinisë heroike!

Nexhmije Xhuglini, dibrania guximtare,
Erdhi si Shqiponjë në Konferencën e Partisë,
Do të luftonte tërë jetën krenare,
Përkrah "Shpatit", viganit të Shqipërisë!

Buzëqeshi si dielli, andej nga Peza,
Babë Myslimi me shokë;
Kur e freskoi lajmi si era:

Rinia në Tiranë, po betohej për këtë tokë!

Haxhi Lleshi, si shkëmb mali,

Po i bashkonte malësorët:

Do luftojmë për liri, o vdekje,

Deri t'í shporrim gjakësorët!

Si vetëtimë mbi male e qytete,

Përhapej betimi; armikut do ia bëjmë fora!

Vojo Kushi partizani, shtrëngonte armët,

Vringëllonte, Hysniu andej nga Vlora!

Lufta e forcoi besën,

Lufta e kërkoi qëndresën,

Lufta kishte dhembje-gjaku!

Lufta, e rriste shpresën!

Lufta e vrau robërinë!

Lufta e vrau tradhtinë!

Lufta çlirimtare, aspiroi fitoren!

Ta gëzojmë lirinë!...

U therrën keq, gjakatarët kryeneçë:

Bishat e Hitlerit, bishat e Musolinit,
Ikën andej nga erdhën:
U strukën në Romë si qyqet,
U mbytën turpshëm nën gërmadhat e Berlinit!

Ata që popujve liridashës,
Tmerrshëm, vrershëm ua nxinë jetën:
I mbuloi tmerri dhe vreri:
Prandaj, e vranë veten!

Gjysmë shekulli drita e 8 Nëntorit,
I ngrohu shqiptarët, nëpër botë:
Fikja e kësaj drite të madhe:
Shekujve, nuk arrihet dot!

RIBASHKIMI I SHQIPËRISË

Kur një popull e fiton diturinë
ndërgjegjen shoqërore dhe maturinë
zëri i tij do të dëgjohet
mendimi i tij po vlerësohet

Në epokën e terrorizmit një gjë dihet
Pushka si argument ka dështuar

Jeta e fëmijës po priset
nga burra me armë në duar

Me ligj të ndërtohet bota
Kjo është e vetmja mundësi!
Të gjitha përpjekjet janë të kota
Pa drejtësi dhe demokraci

Evropa dhe gjithë bota do të kuptojnë
se shqiptarët kërkojnë vetëm barazi
Kur të mëdhenjtë të drejtën mbrojnë
s'ka luftë, vetëm vëllazëri!

TY TA KUSHTOJ
(VËLLAUT TË IDEALEVE, KUSHTRIMIT)

Vite plot stuhi,
Ngarendin si kuaj,
dhe si ujë të tërbuar
më bëjnë mua të vuaj.
Më kujtohet:
Jeta mbi këto peripeci,
Mjerisht na kishte takuar.
Na kishte takuar mjerisht,
Me flakë të përcëlluar.
E, mua më bëhej sikur lexoja
Klithmat e burokracisë,
Thirrrmat ogurzeza të tradhëtisë.
Kushtrimin - zjarr të vegjëlisë.
Të shikoja vëlla, vetullrënë,
Të qetë, por veç pa qetësi,
Të shikoja vëlla të pangrënë
Tek çapiteshe si në pafundësi.
Ishe kush ishe, një shqiptar
Një atdhetar i vëretë,
Ty, ishe në revolucionar,
Kapedan i furtunave në Det-Jetë!
Qëndruam së bashku
Dhe kurrë nuk u lodhëm,
Aty, ku e desh Liria
Si meteorë malësorë,
Aty u ndodhëm.

I kuq je, Flamur!
Se me gjak je ngjyer.
Do të doja që sot,
Sot e nga mot,
Dhe me gjakun tim
Të ishe Ty, i lyer.
Sa kapriçjoze, qenka jeta:
Na ndau vëlla më vëlla,
Me dallgët e veta,
Të hidhurën me vete e ka!
Por, unë vëlla s'të harroj,
Njëherë e kemi bërë betimin,
Për atdheun, truallin tonë,
E kemi hedhur fuqishëm kushtrimin.
Oh, këndej në kurbet!
Ndjenjat më vërshojnë lum,
Mendimet më godasin si çekan,
Shqetësimet më lënë pa gjumë.
Vëlla, kemi nënë e baba,
Kemi fis e çfarë nuk kemi,
Por, para Kosovës hallemadhe,
Bij'të së njëjtës Nënë jemi!
Tek meditoj, këtu në burgun e mërgimit,
S'e harroj çastin e largimit,
Dhe bashkë me kafashatat, gëlltis,
Lotët e dhuruara prej mërgimit.
Heu, sa mallë ndiej për Ju,
Mallë që shpirtin ma përvlon,
Por, dije vëlla, se zemra
Çdo çast tek Ty më dërgon!
Më dërgon me një mesazh,
me gjakun e zemrës, shkruar,
Mijëvjeqarin që po afron,
Trimërisht, së bashku,
Dhe me shokët e një ideali,
kemi për ta kaluar.

MENDIM

Kur mendoj,
Çfarë rrugë - gjaku,
Kryengritjesh vërshuese,
Qe dymijë vite,

Natë pa mbarim,
Veç nga një sy Drite,
Dukej në shekujt
Si në agim!...
Fqinj të ardhacakë, endacakë,
Kurrë, s' u ngopën
Me gjymtyrët tona,
na rrethuan,
Me unaza pirateske,
Flokët më thinjen
Për njëzetë e katër orë
Sa t' i kisha
Dymijë vite,
Në kërkim Drite.
Në ballë rrudhat më shtohen
Si thellësi në hulli!
Në tokën tonë,
na vranë e na dogjën,
Plagë të lashta e të reja
Ma përshkojnë trupin,
Veç zjarret e mëdha
Nga dielloret tona,
Më rinojnë, më forcojnë,
për të ardhmen tonë.

KOHË FURTUNË

Kërkohet!
Kërkohet Qëndresë
Se i përkasim
Revolucionit!
Kërkohet,
Besëlidhje,
Në përpjekëjet
Kundër reaksionit!
Kërkohet,
Sa mës humë ,
Luftë e punë,
Në këtë kohë,
Kohë- furtunë!

KUR TË TELEFONOJ TY

(Vëllaut të idealeve të larta, Kujtimit)

E rëndë qenka , o vëlla, jeta,
Kur përmes stuhive të telefonit,
Të flasësh me bijtë e bijat e
Revolucionit!
Të flasësh pak...
E të kuptosh shumë!...
Kësaj i thuhet bllokadë;
Sikur telat këthehen
Në shpatë!
Zëri ynë tingëllon:
Sfidon , Europë e Ballkan,
Jetë e shqiptarëve:
Jetë, vërtetë katran...
Kohë e ligë e nënshtrimit,
Vite skëterrë të durimit,
O, deri kur, deri kur?!
Shqiptarët, t'ia këthejnë,
Truallin, nderin të parëve?!
Të qëndrojmë maleve me Flamur,
Ashtu siç u ka hije,
Atdhetarëve, çlirimtarëve...

ÇAST

Kam çaste pikëllim,
Kur më vërshon mërzia,
Si shoqe e ëmbël
Më qetëson Poezia.
O, i dashur, i shtrenjtë
Atdhe!
Që kur ne, mërgimtarët
U endëm nëpër botë,
Zjarrin e zemrës po të nisim
E s'po muindemi
Të të ndihmojmë dot...
...Por ka një Çast,
Një çast i madh,
Ardhur nga vet historia,
Që do bëhet si duam ne;
Zonjë, Shqipëria!...

KA KOHË

Ka kohë,
Që nuk po e njohim vetveten!
Ka kohë,
Që dikush e përbuzë të vërtetën.
Ca shqiptarë,
Janë bërë pre
Mbi dhe!
Servilizmi që i poshtron,
Pa vetëdijshëm, i sfidon!
E urojnë!
dhe si burekë,
Përpara botës e shtrojnë!
Lipshur kjoftë,
Kjo dhuratë!
Dhuratë që gozhdon
Në shtrat!
Ka kohë
Që shesin diplomaci,
Por që nuk po mundemi të blejmë
...Shqipëri!
...Sepse, duhet të bëhemi shokë,
Shokë në trimëri.

PIKLLIMI

Më vërshon,
lodhshëm, stuhishëm
pikëllimi.
Heu, ç' ma gërryen shpirtin
trazimi,
trishtimi.
E si hije e keqe
më rëndon
një peshë mendimi!
Nga plagët shekullore
dhe të reja
më godet dëshprimi.
Por, unë duroj,
duroj dhe shpresoj,
shpresoj, veproj dhe uroj:
Shqipëria ime,
doemos një ditë

do të shpëtoj,
e mes shoqesh
si
Shqiponjë,
Qiellit të lirë
do fluturoj.

...DHE MENDOJNË

Në këto vite errësire
ka shpërthyer kori
i zhurmave të "turmave
pa tru" do të thoshte Noli.
Dhe mendojnë disa kokëshkretë,
Se arat s' duhet mbjellë,
Se drithërat mbijnë vetë!
Kanë mbjellë gjyshërit,
Që të hamë ne!...
Veç me durim dhe diplomaci
Do të nderojmë Atdhe,
Do të kemi shpëtim,
Do të kemi demokraci.
Me shpresë dhe vetëm me shpresë,
Do të kemi buk' e paqe,
Doemos edhe liri!...
Dhe me sytë ngritur nga qielli,
Me fytyrën drejtuar nga dielli,
Dhe vetëm shpresë!
Shpresë?! Deri kur për besë?!
Mos ndofta deri kur të vdes?!

URREJTJE!

Urrejtje kurdoherë
kam për ty dhuratë.
Për ty pushtues
që më nise Europës
refugjat.
Si dhe unë
edhe ti je njeri.

Njeri, po me gjak të zi.
Unë dua të rroj,
Në truallin tim të punoj,
Të këndoj lirikën e Atdheut.
Por ti, pushtues
S'më lë të jem Njeri
që t'ia zbuloj
përmbajtjen e vërtetë
fjalës magjike
Liri.

NUK GJEJË PREHJE...

Nuk gjejë prehje në jetë
Pa e parë një dritë,
Që aq shumë e kemi pritë.
Nuk gjejë prehje në jetë,
Pa e parë një fitore,
Për të cilën derdhëm djersë e gjak,
I ri e plak! Nuk gjejë prehje në jetë,
Pa e parë një bukuri:
Ribashkimin e trojeve etnike Me Nënë Shqipëri!
Nuk gjejë prehje në jetë,
Pa qeshë fytyra e Malësorit,
Pa u flakur shfrytëzimi i punëtorit.
Nuk gjejë prehje në jetë,
Pa fituar drejtësia, Pa u thyer e vrarë, tradhëtia!
Pa lulëzuar Shqipëria Etnike,
Pa u dëshmuar me vepra heroike.
Nuk gjejë prehje në jetë.
Pa njohje trimash të vërtetë,
Që atdheut ia falën, Të shtrenjtën jetë!

VËLLAI I MORDJES

Bija ime Yllka,
Ende pa i mbushë dy vjet,
nisë cicërimat e para,
nisë të flet.
Porse, në shqip belbëzon PO
, Në suedisht - NEJ!
Ah, Trishtimi seç më pushton!

Vëllai i mordjes, mërgimi, fëmijën po ma kafshon!

VIKTIMAVE TË TIVARIT

Gjendet një det i kuq, i kuq, i kuq,
Në Ballkanin e Zi.
Brigjeve të Tivarit
Një det-gjak!

NË KËRKIM DRITE

Flokët më thinjen për njëzet e katër orë,
Sikur t'i kisha dymijë vjet
. Jetë,
në kërkim drite!
Jetë stuhi!

MBIJETESA SHQIPTARE

Hijenat hapin kthetrat për tragjedi të reja!
Por, Flatrat e Shqiponjës
, I ndehë rezistenca!

VEL DEMAGOGJIK

Plagët nga thyerjet e ndërgegjës,
po lëngojnë gjak e lot.
Premtimet boshe po lulëzojnë,
Si hije,
gjarpërueshëm horizontin e kristaltë, megjullojnë!..

. ROBËRIA NË KOSTM PAQEJE

Liri e llomotitjes!
Liri e gërmimit!

KËNGA MËRGIMTARE

Seç ma vërshojnë shpirtin
tingujt melankolik
të një kënge epike.

Mbrëmjeve në mërgim,
tingujt rrjedhin

vaj!

LETRA E NJË MIKU NGA VENDI IM

Malësorët druvarë
ikën nga malet,
Nga vetmia lisat
nuk rriten, nuk rriten!

Peshkatarët shqiptarë
ikën nga liqenët,
ato nga vetmia
ujin seç e shterrin!

Kopshtarët herakë
ikën nga kopshtijet,
pemët nga mërzia
nxjerrin fryta lotësh!

Bletarët e zellshëm
i braktisën hojet,
bletët u tmerruan
mjaltën e idhëtuan!

Bujqit plisbardhë
ikën nga arat,
toka po mbetet djerrinë,
trishtueshëm shkretohet.

O, këthehuni vëllezër,
këthehuni në truallin e copëtuar:
këtu keni emër e fytyrë,
dhe jeni të nderuar!

BIOGRAFI GJEOGRAFIKE

Kujtimet vijnë vërshueshëm
herë më freskojnë,
herë më trazojnë

për fushat e gjera bleroshe

për malet e larta krenare!

NDJENJË FAJI

Sa vatra t'í shuam o Atdhe,
kur larg teje ikëm?

Në shtëpitë e braktisura,
zjarrin e lirisë e fikëm!

TRADHTARËT

Dje vazalë.

Sot urith të lëvizjes
për çlirim kombëtar.

Nesër-ngordhësira
kundërmuese
në histori!

DERI KUR?...

Heu, se na mori lumi!...
E dot nuk na doli gjumi,
Na kaploi dehja "demokratike",
Me thirrma hysterike,
Heroizma shqiptare,
Sosë rrugën te liria.
Me diplomaci thinjake
Jo, s' bëhet Shqipëria.

Deri kur, deri kur...
Qënka thënë të presim?!
Që qiellit ndezur flakë
Lirinë n'tokë ta zbresim?

Jemi shtet me emrin Dardan,
Republikë e Kosovës tash,

A nuk do të jemi shtet sovran
Në truallin tonë, pash më pash?

Europa dhe bota "demokratike"
Shikon që derdhet gjak.
Këputet diku një trëndafil,
Diku këputet një zambak.

Deri kur, deri kur...
Kosovë - Nëna ime,
Do t' ma bësh zemrën copë
Dhe shpirtin thërrime?!

GJITHNJË!

Gjithnjë ari ka më pak,
E, më shumë ka teneqe,
Në këtë botë pise,
Në këtë jetë, kryeneçe!
Mbase, e di, -për këtë,
Nuk bëra ndonjë zbulim;
Por, e shkrova -si klithmë,
R E V O L T E!
I rrëmbyer, në trazim!

Suedi, 7 shkurt 2010

ATA!

Ishin dy e mbeti, një

Të dy i përkasin historisë

Njëri turpit, tjetri lavdisë!

Njëri ushtronte maleve, me automat...

E vriste çetnikë e tradhtarë,-në shtrëngatë,

Tjetri , kafeneve i zhytur hareve...

Pinte raki dhe makiadë!

Të dy i përkasin historisë,

Njëri turpit,

Tjetri lavdisë!

Njëri kishte shallë,

Krekosej dhe përgjërohej...

-Për Parisin kishte mallë!

Tjetrin e hijeshonte Plisi

Që ia fali trualli,

Në besim ia dha, fisi!

Të dy i përkasin historisë,

Njëri turpit,

Tjetri lavdisë!

Njëri, natyrisht-mjerisht, -ra!

Kur në kohë ferri e tmerri ,

Puthej e zgërdhihej me shkja!

Tjetri, heroikisht u ngrit,,

Madhështor, deri në qiell,

Dje, kombit i dha qëndresë,

Sot, i shndritë-përbesë!

Hiç më pak se një Diell!

Suedi, 5 Mars 2010

ME TY!...

(Kushtuar veprimtarit atdhetar, vëllait tim të idealeve,

Xhemil Zeqirit)

E dua një kapërcim shtigjeve...

Me Ty, o vëlla!

Të nisemi nga Uji i Sokolave,

Ku shihet Grykë Kaçanikut Legjendar,

E, të çajmë malet...

-Gjer në Kalanë e Tetovës

Në Kalanë e Ulqinit -dhe Janinë,

Të pimë nga një gotë ujë “qelibar”,

Në Valbonë, -e, që andej ...
Të flakëruar me qëndresë,
Të mbërthyer e ngashëryer,
Me shpresa e besë!
Nga heroizmat shekullore!
T'ia shtrojmë vençe, -në Dragobi.
Si kuvenduam, për Mustafë Shytin,
Si kuvenduam, për Tahir Sinanin,
Si kuvenduam, për Teutën,
Si kuvenduam, për Çelo Picarin,
...Dhe, tani, -si po mbledhim forca;
Për beteja të reja...
Me Bajram Curr Shqiptarin.
Të shtegtojmë e të lundrojmë,
Cep më cep...
Maleve, fushave, deteve,
Të jonit -Atmëmédheut,
Atje, -ku krismat e heroizmat,
Mbollën lule liridone...
Në sulmet rrufe!
Lule që, -breznitë shekujve,

I ujitën:

Me djersë, lot e gjak!

Shqipërisë Etnike,

Nderin ia ngritën!

Ndërsa, ne, -po i ujisim,

Me shkronja arbërore,

Me ide qëndrese!

Pak nga pak...

-Të çelikta, të përpikta!

Pa hezituat t'i dënojmë:

Armiq e tradhtarë,

-Flakë për flakë!

Dua të dalim andej,

Se, zemrat po na vlojnë,

Flakë e barot!

Se, shumë gjatë...

...Dhe, pamëshirë!

Kjo jetë, teh-shpatë,

Po na vret përditë...

Në mërgim-trishtim,

Nëpër botë.

Suedi, 5.04.2010

TY, O SHPIRTBARDHI YNË!

(Mikut tim të nderuar, Ahmet Mustafës, (plakut) -me rastin e 25 vjetorit të vdekjes, më 12 prill 1985).

Me të kishim miqësi,

Dhe, kishim ideale -vëllazëri!

I kemi përshkuar-vizituar,

“Kronin e Ujkut”, “Kronin e Hajdutit”,

Kronin e Komitëve”!...

Shpat më shpat, -brinjët e Qyqavicës,

Krua më krua, -ujë kemi pirë,

Istikameve kemi vigjiluar...

Ishim tek “Karakollet", atje mbi male,

Ku shihej, tërë Rrafshi i Kosovës,

Dhe, Drenica Halle madhe!

Në atë kohë të errët –tejet të vështirë!

Ideja, jonë ashtu buronte,

Përjetësisht, e dallgëzuar, e pashuar!

Më ka rrëfyer për istikamet e Azem Galicës,

Më ka rrëfyer si, serbët

Ia kishin vrrarë babanë.

Sytë sikur i nxirrnin -flakë e shkëndija,

Nga vuajtjet , -sikur nuk ngopej duhan!

Ay, plak i sertë dhe bujar,

I deshi shumë Trëndafilat dhe Enver Hoxhën,

-Siç mund ta donte e respektonte,

Legjendarin Madhështor,

Dhe, natyrën shqiptare,

Një bletar e blegtor!

Më 11 Prillin e zi, të vj. '85,

Kur e mori lajmin...

Se, Enveri na la!..

Nga dhimbja, - lotët i vërshuan:

Ra, një Yll i madh i kombit -tha!

”As unë, as unë...

Nuk dua të jetoj pas tij”!

Me drithërima -në shpirtin e bardhë:

Parashikoi, stuhi!...

Druaj, -tha: se, Shqipërinë:

Do ta sundojnë-puthadorë e faqezi!

Druaj -tha, -ai malësor:

Se, Shqipërinë, -do ta sundojnë,

Dhe, mizorë!

...Atë natë nuk fjeti...

Piu, shumë kafe e duhan,

Qau për Enverin,

Siç rënkoi, një vatan!

Të nesërmen u zgjuan,

-E ftuan:

Eja, të hamë mëngjesin...

-Si kurdoherë:

Me djathë, tamel e gjizë...

O, nuk më hahet -as më pihet -tha!

...Më tej , -s' foli dot!

Papritur, u trand, -si toka,

-NJERIU!

Qengjat blegëruan...

Të alarmuar me dele!

Bariu, Ahmet Mustafa , -i urtë,

I mbylli sytë,

Përjetë...

Ndërsa; - o sa hata!

Pas 25 vjet parashikimi

I hidhur, -i tij; doli:

Shqipërinë; -pushtetarë trutharë,

E, puthadorë e mizorë,

Me të huajt faqezinj!...

Po e bëjnë thele-thele,

Po bëjnë kërdi!

As malet, tokat, as detet,

Nga korrupsioni -s'po iu mjaftojnë!

Shqipëria, po ricopëtohet -nga kusaria,

Përderisa, kështu, shqiptarët -po i durojnë!..

Suedi, 12 Prill 2010

Fadil Shyti: TREGIM

Publikuar më 25 tetor, 2009 |

AH! SA NDJEVA MALLËNGJIM PËR TË KALUARËN E ATMËMËDHEUT TIM!

Gjatë një dite tetori, meditova: Ah! Sa ndjeva mallëngjim për të kaluarën e Atmëmëdheut tim!

- Ah! ndjeva një mallëngjim të rrallë!...

E, përse, më rrëmbyen ato valë që e përcëllonin trupin tim, që e trazuan shpirtin tim mërgimtar?!

Për ato dasmat tona madhështore, për ato... kur jepej aq shumë bukë e kripë me zemërgjerësi; shumë madhështore!

- Kur shpalosej bujaria si palët e Flamurit kuqezi.; kur shkëlqente mikpritja me aq shumë dashuri dhe kur krisma armësh jehonin, me ç'rast aq shumë krijuan dhe vetë-kurajë dhe qëndresë e shpresë për popullin dhe pasiguri për të huajt okupatorë.

E paharruar dhe e çelikosur në shekuj, kjo traditë kombëtare e krenare, ishte!

Si valë freskie dhe zjarrmie - njëkohësisht më vijnë ndërmend; ato kujtime; burrash e grash që, me aq përkushtim kujdeseshin për më shumë gëzime në fytyrat e fëmijëve të padjallëzuar.

- Po, në ato dasma, përkundër se fshihej dora e zezë e armikut me veglat e tyre qorre – horrat e tradhtarët; megjithatë, kurrë nuk heshtën, por gjëmuuan e jehuan aq shumë këngë e pushkë sa tundej dheu në malësitë tona. Po, në ato dasma kurdoherë, kishte fytyra të qeshura e të bukura si rrezet e diellit!

Në veçanti në sytë e fëmijëve dhe në zemrat e tyre vlonin dëshirat dhe kënaqësitë për t' i parë dhëndrin dhe nusen; - si shkëlqenin me ato kostume festive; si dy trëndafila, që jetës i buzëqeshnin në ardhmëri!...

Kur mbi ta hidhej sheqer, që kjo figurë e simbolizonte dëshirën për të pasur një jetë të ëmbël, përkundër vështirësive që mund t' u sillte atyre jeta! –

Kësaj mrekullie rituale shekullore, herë-herë i shtohet dhe orizi; që jeta e tyre të jetë e bardhë dhe e frytshme si ajo bimë e mrekullueshme! Po, a nuk flet kjo për një popull të etur për paqe dhe liri, në trojet e veta stërgjyshore?!

Ah! Sa ndjeva mallëngjim për të kaluarën e vendit tonë; që jo pa arsye miqtë tanë të huajt e kanë quajtur kurdoherë: "Vendi i shqiptarëve"! Shpresoj, që secilit shqiptar do t' i duket e natyrshme kjo imagjinatë!

Po, ato anekdotat, humoret dhe alegoritë popullore!? A nuk kishte tek ato një vërshim idesh filozofike të pavdekshme?!

Po, ato rrëfime me plot bujari për ngjarje të ndryshme jetësore! E, në veçanti nga pleqtë tanë trima dhe të urtë. A nuk përshkruhet e rrëfëhet aty, historia e përjetuar me zemra, jo nga shkrimtarë të pispillosur e të stërholluar "modernistë", por me shkrimtarë popullorë të pabotuar – pra veprimtarë që i ka nxjerrë jeta ndër kohëra stuhish!

A nuk do t' i tingëllojë kjo imagjinatë e zjarrtë si kambanë; çdo shqiptari e shqiptareje atdhetare, si shumë i qëlluar ky mallëngjim, kjo evokueshmëri që buroi nga zemra ime e zhuritur për Atmëmëdheun tim?!

- Për më tepër, kujtoj që kjo është një mbresë e pashlyer nga gjurmë gjaku e lotësh; gëzime dhe hidhërime - që ka arritur deri në

këtë kohë harrese nga qeverisjet e bastardëve që po e rrënojnë traditën me zhurma të huaja "moderniste", që po e lëndojnë përkohësisht, por nuk mund ta eliminojnë kurrën e kurrës dhe kulturën e pasur kombëtare!

- Gëzime kishte në dasmat tona, por tek ato bërthama jetësore kishte dhe tragjedi; që burimet i kishin tek fara e keqe dhe tek faqja e zezë e robërisë!

Kultura jonë, kjo kala me armë e pathyeshme ndër shekuj i ka thyer e tejkaluar dhe i ka mbërthyer e ngulfatur për fyti shumë "izma" trashanike të kësaj kohe moderne; ku gjithçka shkëlqen e vërshëllen si teh shpate, se bërthama e kulturës kombëtare, e cila na solli deri këtu si komb dhe na shpëtoi përballë asimilimit përballë kombeve shumë më të fuqishme e më mëdha!

Kot u vërsulën me falanga e ushtri piratët e përtej-deteve dhe cubat e përtej maleve tona krenare!

Ato, mund të qëndronin si mysafirë të paftuar; - vetëm, përkohësisht në trojet tona; por kurrën e kurrës për asnjë çast e për asnjë ditë nuk ishin të lirë, sepse toka, qielli dhe deti ynë ishin të huaja për 'ta!

Nuk ishin të lirë; - sepse shpirti liridashës i shqiptarit kërkonte jo vetëm i zgjuar, por edhe në gjumë, të ishte i lirë prej tyre!

Dhe, jo më kot xhaxhai im atdhetar, Sadiku, thoshte: - "Toka jonë biro s'e duron as farën e misrit të huaj, pa lëre më të huajin"

Prandaj, populli ynë - kurrë nuk pushoi së vepruari, ishte vigjilent dhe as përkohësisht, kurrë s'e zuri gjumi!...

Ishte e huaj dhe gjuha jonë, e cila i sfidoi kudo dhe kurdoherë!

Po, a nuk e kemi ne iliro-shqiptarët - një gjuhë të lashtë indoevropiane; prej së cilës ushqehen dhe freskohen; gjuhët mike dhe tërbohen e përjargësohem apo lëshojnë klithma memecërie - gjuhë të tjera të globit; madje, ato të kombeve që dhjetëra herë janë më të mëdha?!

- Po, si mund të harrohen nga kujtesa, ato përgatitje tradicionale të kostumeve burrash e grash, që të kujtonin në imagjinatë, Iliriano-Arbërinë?!

Se, vetëm në Iliri, ilirët - paraardhësit e arbrit - shqiptarët e sotëm ishin vërtetë të lirë!

Ishin të lirë, sepse këmba e ndyrë okupatore sllave nuk kishte arritur të ndrydhë dheun tonë të lashtë, nuk kishte arritur të shtypë qenien tonë! Të bastardhojë gjuhën tonë të lashtë epike... Them epike sepse, asgjë më shumë se epizmi nuk u nxor me zjarr nga kjo gjuhë etnike dhe -përtej antike... Prej atëherë kur as perënditë nuk flisnin, por kujtoheshin vetëm në statuja!

Po, a kishte pamje më madhështore, që ua kalonin diellit, hënës dhe vetë qiellit me gjithë ato planete se këto:

Po, të pastër si bora me veshje kombëtare, të kuqë si gjaku me flamuj e me shoka kombëtare, me jelekë dykrahësh si shqiponja dykrenore...

Oh! Sa mrekulli e pamje e bukura skenike ishte, a nuk ishin ato pamje të denja për gjirime filmash, që bota idilike me përkushtimin dhe kënaqësinë më të madh do t'i himnizonte!

- Dhe, njëkohësisht jam i bindur se as të tërë filmat dhe dramat e skenave botërore më mirë nuk mund t'i gjirojnë!...

Këto ishin burimet tona, të qëndresës, të nderit e të besës; - këto ishin rrënjët tona që nuk njihnin as do njohin morde në stuhitë, ndër mote!

Prandaj t' i ruajmë si sytë e ballit, t' i ruajmë jo vetëm në kujtime dhe meditime; përtej Atmëmëdheut; por t' i ruajmë në Atmëmëdhe; - përditë, duke i vënë në jetë; në dasmat tona të ardhmërisë dhe me artin tonë madhështor e të pavdekshëm si vet jeta!...

T' i ruajmë të pastra pa ndikime gjuhësh, kulturash dhe flamujsh-lecka të huaja; që po na imponohen sot, si dikur në kohëra të errëta të perandorive të etshme për pushtime; me mashtrim e dhunë nga të huajt.

Shkruan: Fadil SHYTI

Mendime për emigrantët:

Kur njerëzit nuk janë në gjendje të qëndrojnë përballë sfidave të jetës e të sakrifikojnë në

Fadil Shyti

vendin e vet, përjetësisht sakrifica dhe dobësi të pandërprera do t'u bien mbi kokë, atje larg në vendet e huaja...

Fatkeqësitë tepër shumë i ndjekin emigrantët dhe jetën ua shëndrrojnë në fatkeqësi, paksa të mbuluara me perde demokratike.

-Këtë e provuan gjatë ikjes dhe jetës në "parajsën" e premtuar, shumë emigrantë!

MËRGIMI ËSHTË NJË BURG I HAPUR! (Autori)

Epilogu fillon:

Emigrantëve edhe kur duket se iu buzëqeshë fati, kjo buzëqeshje u ngrinë në buzë!

Emigrantëve, u sillet fati i zi mbi kokë, për faktin se gjeni i tyre mbetet përjetësisht si qyqarët dhe si qyqet nëpër botë!

Emigrantët, vdesin kufijve të shteteve të huaja "parajsa" të premtuara perëndimore.

Emigrantët, vdesin shkretëtirave, mbyten në puse , maleve copëtohen nga ujërit, aty ata e mësojnë abc-në shumë të dashur të "demokracisë"!

Emigrantët, vriten pamëshirë nga rojet kufitare, aty ata e mësojnë së dyti gjuhën e vendeve të huaja mike, trupat e tyre të pagjetur humbin pa nam e pa nishan.!

Emigrantët, fatkeq, mendje-shkurtër, rrugë-gjatë e të pakthim, duke ikur kufijve modernë të rrethuar me tela elektrikë, i mbysin aksidentalisht fëmijët e tyre, të cilëve ua mbyllin gojët për të mos qarë, që të ikin në heshtje; ua mbyllin gojët me çokollata o me çorape.

Kjo tragjikomedi moderne, vrasje marrëzie, gjakftohtësie, apo jo?!

Emigrantët, u besuan verbërisht premtimeve dhe veseve të jetës demokratike ku njerëzit janë të lirë të humbin (ikin) nga të duan ; pa asnjë përgjegjësi morale, kombëtare as njerëzore...

Emigrantët mendjehhtë, modernë trasojnë idenë "kozmpolitike" se atdheu i tyre qenka aty ku jetojnë, ide që ngjason me jetën shtazarake apo jo?!

Tani, vetiu shtrohet pyetja: vallë a mendojnë, a vuajnë shtazët për atdhe?

Vallë, a u dhimbset atyre vendi ku u lindën dhe u rritën?!..

Deri sot, këtë dukuri, shkenca se ka vërtetuar!...

Prandaj, natyrshëm mendohet se jo!...

Nga kjo mund të konstatojmë se: ato kënaqen nga ushqimi kalorik, nga shtroja e mbuloja e duhur, prandaj "logjikisht", s'kanë përse të vuajnë fare për atdhe!

Apo, kur i vlerësojmë kështu, mos po u hyjmë "të gjorave" shtazë në hak!...

Apo, mos tani kemi të drejtë të na kujtohet që shkencëtarët dikur paskan konstatuar që: njerëzit qenkan shtazët më të përsosura të rruzullit tokësor!

Pra me "sivëllezërit dhe simotrat" e tyre, qenkan ata/ato, (kudo që jetojnë, brenda e jashtë atdheut) që kujdesen vetëm për veten e vet.

Vallë mos qenka kjo lidhje gjenetike e instinkteve të tyre?!...

Epilogu vijon:

Emigrantët, pastaj i humbin familjet në errësirën e netëve të maleve dhe në përcëllimë - dritën e neoneve në sheshet vrastare në vendet e huaja!...

Emigrantët, mërdhijnë nga dimrat e ikjes e të pritjes, bien dhe bëhen lesh e li nga kthetrat e banditëve që majmen me prostitucion, drogë, e nga krimet më të tmerrshme misterioze që as djajtë s'mund t'ua kalojnë.

Ato rrokullisje jetësore në kokë e n'bisht dhe në bisht e n'kokë, ua kalojnë dhe fatkeqësive të mëdha të luftërave, këto beteja janë të përditshme, të pambarimshme, ndërsa luftërat e tmerrshme përfundojnë një ditë apo jo?

Në këto beteja jetësore, viktimat klithin por nuk dëgjohen, ato gjëmojnë por rënkimet e tyre mbyten nga uturimat e makinave luksoze të diplomatëve modernë të botës cinike, demokratike të cilat shkëlqejnë nga paqja e tyre e përgjakur dhe e përflakur!

Emigrantët, jo rrallë digjen e përvëlohen shpirtërisht dhe fizikisht!...

Ata, jetojnë në kazerma ushtarake, në ahuret e kuajve, sikur kjo donë t'i paralajmërojë: ja këtë fat do ta keni, përjetësisht do të jeni

të ngarkuar me bagazhe jetësore, sa që djersa ballit dhe shkuma nga zallahia dhe mërzia e lidhjes, do t'ju shkon rrëke!..

Sikur atyre që ju shkonte kur jetuan këtu para jush!...
Mos harroni o njerëz se edhe shtazët nga pesha e rëndë e jetës mërziten!...

Emigrantët, digjen bëhen shkumb e hi nga zjarret në banesat e vjetra të metropoleve " të reja" euro-atlantike, ku jetojnë në vendet mike!!!

Emigrantët, jetojnë në "shtëpi" lundruese pra në anijet ku i lidhin brigjeve të detrave të rrëmbyeshëm dimrave të acartë, dimrave vrastarë...

Atyre, aty u mungon ajri, por kjo s' i pengon shumë, sepse ujë të kripur kanë me bollëk, nëse s'ju pëlqen jeta e burgut modern, lirinë çmendurake të kërkuar e kanë: mund të hidhen e ta lënë "parajsën" e kësaj bote të madhe për ta "gëzuar" parajsën e amshimit!...

Epilogu vijon:

Emigrantët, bien viktima nga trafikantët skafistë-fashistë, detrat i skuqin me gjakun e tyre, sepse ata nuk u skuqën kur ia kthyen atdheut të varfër shpinën!...

Emigrantët, e kanë pa kohë të caktuar qëndrimin në vendet e huaja, por me kohë të caktuar, qëndrimin në vendin e vet!!!

Prandaj, toka çuditet me këto krijesa që sillen si robotët nëpër botë.

Toka nga poli në pol, rrëqethet, qielli nga cepi në cep, habitet gjithashtu, kur zvarriten me bagazhe; tronditen kur i dëgjojnë që kur nisen drejt atdheut qajnë nga gëzimi, ndërsa kur kthehen në vendet mike, qajnë nga hidhërimi.

Pra, jetojnë as aty as atje, as në tokë të vjetër as në tokë të re!
Me lot e fillojnë, me lot e mbarojnë jetë-robotinë e tyre!...

Emigrantët e habisin tokën, detin, qiellin kur lënë amanete kur janë "më së miri", sikur tokën e përbuzin kur thonë: "mos më varrosni këtu, në vend të huaj, por varrosmëni atje, në atdhe"!

Toka, e huaj tundet, pastaj ndodhin tërmete nga hidhërimi, sepse këta njerëz bukëshkalë po më përbuzin-thotë.

Eh, sa herë për këtë edhe qielli ka lëshuar gjëmime...

Qielli habitet, tronditet, kur emigrantët fluturojnë si zogjtë shtegtarë herë andej, herë kënde, aeroplanët shpesh s'e mbajnë dot peshën e tyre të vuajtjeve, prandaj idhshëm bien i përplasin vdekshëm, mbi dete, male, fusha o shkretëtira.

Përfundoni kështu njëherë e mirë, sikur u thonë me uturima, krismash...

Natyrisht, duke rënë ata, bien pre edhe shqiponjat autoktone të cilat ishin duke fluturuar hareshëm në vijën e ajrore të jetës...

Emigrantët, bëhen kështu, detrave gjah për peshkaqenët, maleve gjah për ujqërit, fushave gjah për qentë, kur shigjetohen, shqelmohen nga "rruga moderne" e pilotëve të dehur, vrastarë e të marrë, kur bien nga qielli si pendla korbash!...

Me mërgimtarët qielli çuditet kur i dëgjon kur thonë; klima në vendet e huaja s'po na pëlqen!!!

Dielli, ngryset, ironizon kur i dëgjon kur thonë: as dielli s'po na ngrohë si në vendin tonë!...

Edhe malet shpesh digjen flakë nga thatësia e shpirtrave antinjerëzorë, nga sjelljet e tyre me emigracionin, kur i shtypin me segregacion, zotërinjtë mizorë!...

Emigrantët, qajnë "rrallë" apo jo?!

Kur lotët e tyre vërshojnë, qytete e katunde të tëra lagen, vendësit mendojnë se ato janë ujëra, se janë lotët e ardhacakëve ata kurrë këtë s'do ta kuptojnë!...

Uji, herë-herë sikur ndalon, kur i dëgjon kur thonë: "si uji i burimeve tona s'ka në botë"!...

Buka, herë-herë ftohet, ngurtësohet kur i dëgjon që thonë: si buka e magjeve tona s'ka në botë!

Me emigrantët edhe pemët e perimet çuditën kur i dëgjojnë kur thonë: si kopshtijet e vreshtat, parcelat e serave tona s'ka në botë!

Ato, kurrë s'i freskojnë si atëherë, anipse ruhen të konservuara nëpër frigoriferët modernë...

Vallë, mos kështu edhe lirinë e popujve reaksioni ndërkombëtar imperialist e ka bartur e ngrirë nëpër frigoriferë, pastaj popujve ua jep si lëmoshë për aq sa dëshiron, duke ua shkrirë në copa- copa, sipas orekseve të tij, apo më saktë, sipas presioneve nga popujt...

Në fakt kjo liri në vendet e huaja emigrantët nuk i kënaqë, sepse jo rrallë ata i ndjekë si hije një dozë pelimsie, dridhëse pasigurie e cila mund t'i gëlltis, apo mund t'i ndezë flakë brenda natës...

Emigrantët janë si lisa apo shelgje të pa rrënjë që gjelbërimi i tyre zgjatë vetëm për ca orë e ndofta për ca ditë, pastaj vyshken papritur mjerueshëm, trishtueshëm...

Emigrantët jetojnë një jetë brenda-jashtë; ditën jashtë, natën ëndërrojnë, shkojnë brenda në atdhe.
Jetë kjo e çudirave, e mrekullive që shkëlqen me lot...

Emigrantët, shpresat si rrobet më të shtrenjta në valixhe i ruajnë, fatin e vet nuk e nënshkruajnë!
Ata zakonisht "përkohësisht", jetojnë larg, madje deri në amshim, por në zemra e ruajnë dëshirën për kthim!...

Jo, jo se nënshkruajnë dot fatin e tyre, në këtë botë të hidhur, lajkatare si lavire...
Shpresojnë se kthehen në atdhe ta jetojnë jetën e jo rrallë në arkivole larg atdheut mbërthehen në fronte me vdekjen.

Meqë jeta sillet e mbështillet, tallet me ironi e cinizëm, natyrisht jo kurdoherë të gjithë me fajin e tyre, janë tragjikët më fatzinj të kësaj bote...

Ata, shtypen me përbuzje, plagosen rëndë nga plagët shoqërore që u vringëllojnë mbi kokë, që u rëndojnë mbi supe si shpata dhe ushta mizore; ata përballen me papunësi, shkilen me injorim, përbuzen në heshtje paqësore, nga sindromat fashiste vetëm përse janë të huaj, prandaj tmerrshëm vuajnë; me strese mizore e pinë kafën e mëngjesit, me lypësi e fitojnë drekën, ndërsa darkën e hanë pa shpresa iluzore!!...

Emigrantët, jetojnë realisht, jashtë rruzullit etnik, ndërsa ëndërrueshëm shkojnë e vijnë atje vërtik!

Por, këtu qëndron një fatbardhësi, që toka mëmë, i merr mërgimtarët në gjirin e saj!
Nuk i akuzon, nuk i quan bukëshkalë, ani pse dikush pjesërisht e dikush krejtësisht ishte i tillë...
Por, mesiguri kishte të tillë që s'ishin bukëshkalë aspak!..
Disa u pasuruan shumë, por nuk menduan për atdhe aspak!...
Disa, u varfëruan dhe u pakësuan si mos më keq, kjo që "shpërblimi" jetësorë!
Por edhe pse jetuan jashtë, ishin kurdoherë krahët i truallit stërgjyshor!

Emigrantët, gjuhë kanë dhe flasin, por memecërinë e zhvillojnë, identitetet kanë por nga sulmet e huaja shumë prej tyre pas një kohe mjerueshëm e harrojnë!...
Fëmijët e tyre lozin jo vetëm me kukulla, por ata lozin e zhyten edhe në kënetat e tjetërsimit-asimilimit.
Fëmijët e tyre rriten larg ngrohtësisë së gjerë familjare, larg popullit të tyre, larg edukimit, artit, kulturës dhe identitetit autokton, ata rriten në një ambient të huaj ku këto mrekulli kombëtare nuk thithen si ajri, nuk shijohen si buka, nuk shkëlqejnë dhe nuk ngrohin si dielli!
Ata, rriten si të humbur, bëhen si filiza të huaja!...

Kjo tragjedi paqësore, ata i shkrinë si copa bore - siç do të thoshte një luftëtar i madh i të drejtave kombëtare dhe njerëzore, (Adem Demaçi).

Për mërgimtarët, bashkëvendësit e tyre kujtojnë se kanë gjithçka, ndërsa ata s'kanë asgjë, ata s'kanë ardhmëri kombëtare, për fëmijët e tyre...
Emigrantët, mund edhe të kenë pasuri përralore, por kjo nuk ka peshë, pra s'ju vlen, se janë pa atdhe.
Mund të kenë një liri që në dukje shkëlqen, por kjo liri, ata i lë krejtësisht pa fëmijë, sepse i fundosë asimilimi, pas një kohe ata tretën, ata janë gjithkund e askund s'mbeten...

Prandaj, kujdes o njerëz!

Mos u mashtroni nga lakmitë e botës së huaj, por qëndroni krenarë në vendin tuaj!

E sotmja e hidhur që ju ka mbërthyer përkohësisht, do të ikën si gjarpërushe e mundur një ditë, ndërsa ardhmëria që njerëzit i lidhë si kjo bollë xhelate, larg vendit të tyre si lëshon dot, as sot as mot. Fatlum, shumë fatlum, janë ata që i shpëtojnë...

Sepse o njerëz, kjo bollë pamëshirë ju lidhë e ju shtrëngon idhshëm, pastaj ju mund përjetësisht!

Qëndresë o njerëz!

Mos ikni nga vatrat tuaja stërgjyshore, mos na lakmoni ne që ikëm e ramë në këtë kurthë mizore!

Kujdes, se për besë nëse ikni, do të pendoheni përjetësisht deri në amshim!

Epilogu krejt natyrshëm kështu përfundon:

Emigrantët, nga gjithë këto beteja jetësore, nëse nuk i qasen atdheut, me dituri, trimëri o me pasuri; ata shkojnë drejt vdekjes së turpshme si jobesimtarë.

Sepse, nuk rezistuan, nuk qëndruan stoikë e t'i sjellin liri dhe nderë atdheut që i lindi dhe i rriti, prandaj liria dhe nderi u humbi; fillimisht nga shpirti, pastaj përjetësisht u mungoi pikërisht atyre, që e bënë mëkatën e madh duke ua kthyer shpinën të gjallëve dhe të vdekurve të tyre!...

Lum ata/ato, që i rikthehen truallit të tyre, lum ata/ato, që e shpëtojnë gjenin e tyre nga tretja tinëzare, nga tretja vrastare që me shekuj po kalëron si kob nëpër botë!

Suedi, 05.09.2005